



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 773/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtaret Ferki Xhaferi kryesues, Afijete Sada- Gllgjani dhe Adnan Konushevcu anëtar, duke vendosur përkitazi me ankesën e Seki Kandič nga Banja, Komuna Istog, kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për manipulim me votues nga jashtë vendit për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.11.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**HUDHET** e pasafatshme ankesa Anr.733/2021 i datës 04.11.2021, e paraqitur nga Seki Kandič nga Banja, Komuna Istog, për manipulim me votues nga jashtë vendit për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal.

## A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 04.11.2021, ka pranuar një ankesë nga Seki Kandič nga Banja, Komuna Istog me të cilën pretendon se gjatë votimit në Banjë, Vernicë dhe vende të tjera në komunën e Istogut, Subjekti Politik Gordanska Inicijativa Bosnjaka Istok – GIBI, ka manipuluar me votuesit jashtë vendit. Përfaqësuesit e listës GIBI gjatë pushimeve vjetore ua ka marrë letërnjoftimet disa votuesve, i kanë regjistruar në Komisionin Zgjedhor Komunal dhe pas kthimit të tyre në Evropë kanë votuar në emrin e tyre edhe pse asnjëri prej tyre nuk ka qenë në Kosovë ditën e zgjedhjeve. Apelit i ka bashkangjitur deklaratat e dy personave që pretendon se dikush tjetër ka votuar në emër të tyre.

Paneli, pas shqyrtimit të lejueshmërisë së ankesës, në këtë fazë të procesit zgjedhor, gjeti se,

**Ankesa është e palejuar**, për këto arsye:

Paneli, vlerëson se në këtë fazë të procesit zgjedhor kur është dorëzuar ankesa në PZAP, me pretendime nga ankuesi se ka pasur parregullsi gjatë ditës së votimit nuk mund të procedohet si ankesë e afatshme, sepse në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, i LZP-së, i ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-256, përcaktohet se: *“Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QNR dorëzohen me shkrim pranë PZAP-it brenda njëzetekatër (24) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar”*, nga kjo rezulton se në këtë fazë të procesit zgjedhor që ndodhemi, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, për kandidatë të Kuvendit Komunal me datë 03.11.2021 mund të parashtrihen ankesa në PZAP, vetëm për rezultatet e

shpallura nga KQZ-ja. Me asnjë dispozitë ligjore të LZP-së, e me asnjë Rregull Zgjedhore, nuk parashihet mundësia që të konsiderohet e lejueshme një ankesë, që ka të bëjë me parregullësitë gjatë ditës së votimit apo pakot e fletëvotimeve nga votuesit jashtë Kosovë, të cilat pako të supozuara me fletëvotime, që nuk janë verifikuar dhe numëruar nga KQZ-ja, para rezultatit përfundimtar.

Paneli, vlerëson po ashtu që edhe nëse i referohemi nenit 106 paragrafi 1, të LZP-së, i ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-256, në të cilin përcaktohet se: “KQZ-ja certifikon rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve, pas përfundimit të të gjitha procedurave në vendvotime dhe qendrat e numërimit si dhe kur të gjitha ankesat që u përkasin votimit dhe numërimit të vendosura nga PZAP-i dhe çdo apel ndaj vendimeve të PZAP-it lidhur me to të jetë vendosur nga Gjykata Supreme e Kosovës”, nga kjo del se mund të paraqitet ankesa ne PZAP vetëm ndaj vendimit të rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve që i publikon KQZ-ja, pas përfundimit të të gjitha procedurave. Por nuk mund të jetë një ankesë e lejueshme në këtë fazë të procesit zgjedhor pas afatit, pasi që pas publikimit të rezultateve munde të goditet vetëm vendimi për rezultatet përfundimtarë dhe jo procesi i administrimit zgjedhor në ditën e votimit.

Nga arsyet e theksuar me lart, e në kuptim të nenit 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

Anr.773/2021 më datë 05.11.2021

**Kryesuesi i Panelit**

Ferki Xhaferi



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.